



Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Prudato Received / Delivery	22. 04. 2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTKCK	2347	2022	1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.230/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.230/2022 të datës 14.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.04.2022 mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.230/2021 të datës 14.03.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prishtinës në bazë të Kontratës për punë dhe detyra specifike e nënshkruar me datën 22.11.2021 nga Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datën 14.03.2022 parashtron ankesën me numër protokollit 1330/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 23.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Prishtinës, ndërsa me datën 08.04.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.230/2022 me numër të protokollit 1330/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 14.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë-Ankesë e datës 13.11.2021 drejtuar Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Kërkesë

për sqarime e datës 25.03.2021; Informim –përgjigje në kërkesë e datës 22.11.2021; E-mail zyrtar i datës 08.11.2021; Raporti i punës i datës 01.01.2020-30.12.2020; Kërkesë për sqarime i datës 06.11.2021; Sugjerim i datës 12.03.2021; Kërkesë për sqarime e datës 25.03.2021; Njoftimi publik për kushtet ndërtimore të parcelës kadastrale nr.847-4 ZK Sofali i datës 14.06.2021; E-mail zyrtar i datës 02.09.2021; E-mail zyrtar i datës 29.10.2021; Raport nga konsulta i datës 20.11.2021; Informim për procedurën e Endoskopis i datës 12.01.2021; Raport mjekësor i datës 23.11.2021; Raport specialistik i datës 21.01.2021; Përgjigje në ankesë e datës 08.04.2022 nga Komuna e Prishtinës dhe Kontratë për punë dhe detyra specifike e nënshkruar me datën 22.11.2021.

Ndërlidhur me këtë pjesa VII e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësit administrativ dhe mbështetës, ku neni 82 i këtij ligji, përcakton se: *“Përveç se parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës”,* mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil, ndërsa ankuesi marrëdhënien e punës e ka filluar në pajtim me dispozitat e Ligjit të Punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.230/2022, datë 22.04.2022

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së,